



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 58/16

Prishtinë, më 19.5.2016, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Adem Grabovci, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta dhe Fikrim Damka.

Munguan: Jelena Bontic, Bali Muharremi dhe Enver Hoti.

Pjesëmarrës të ftuar: Agim Krasniqi – zv.ministër i financave, Flutra Blacori dhe Mirlinda Dreshaj nga Njësia e Intelegjencës Financiare.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Fjolla Uka – monitoruese nga KDI, Sanije Berisha nga OSCE, Petrit Balaj dhe Ali Krasniqi nga Shoqata e Bankave, Shefki Kastrati nga NDI, Valon Dobruna nga Administrata e Kuvendit.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Isein, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit

Kryetari - theksoi se duke pasur parasysh faktin së shqyrtimi i këtij projektligjit duhet të bëhet me procedurë të përshpejtuar, atëherë në të ndalemi në vërejtjet dhe propozimet konkrete.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I. Komisioni shqyrtoi dhe amendamentoi Projektligjin nr. 05/L-096, për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit me amendamentet e propozuara, i procedim për vlerësim në komisionet e tjera të përshtershme, si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 1, paragrafi 3, teksti “Ky ligj implementon Direktivën e ”, zëvendësohet me tekstin “Ky ligj ka për qëllim implementimin e Direktivës së”.

Amendamenti 2

Neni 2, në përkufizimin **1.2. Akt ose Transaksion i Dyshimtë**, fjala “gjeneron”, zëvendësohet me fjalën “krijon”

Amendamenti 3

Neni 2, në përkufizimin “**1.6. Bankë**”, fjalët “Ligjit për Bankat në Kosovë”, zëvendësohen me fjalët “Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare”

Amendamenti 4

Neni 2, në përkufizimin “**1.33. Person i ekspozuar politikisht**”, nënparagrafi 1.33.1. riformulohet me tekstin si në vijim:

“1.33.1. persona fizikë të huaj apo vendorë, të cilët janë ose kanë qenë të ngarkuar me funksione të larta publike dhe përfshin si në vijim:”

Amendamenti 5

Neni 2, përkufizimi 1.33.1.5., pas fjalës “anëtarë” shtohen fjalët “të Zyrës Kombëtare të Auditimit,”

Amendamenti 6

Neni 2, përkufizimi “**1.37. Sekuestrimi**”, riformulohet me tekstin si në vijim:

1.37. Sekuestrim - ndalimi i transferit, konvertimit, vendosjes ose lëvizjes së fondeve ose ndonjë prone tjetër mbi bazën e një vendimi të një gjyqi ose autoriteti tjetër kompetent dhe për kohëzgjatjen e vlefshmërisë së tij. Fondet ose pronat e tjera të sekuestruara do të mbeten pronë e personave ose subjekteve që kishin interes në fondet ose pronat e tjera të veçanta në kohën kur u bë sekuestrimi, por do të vazhdojnë të administrohen nga autoriteti kompetent.

Amendamenti 7

Neni 2, në përkufizimin “**1.38. Subjekt**”, fjala “parti politike”, zëvendësohet me fjalën “subjekt politik”

Amendamenti 8

Neni 4, paragrafi 3, pas fjalës “Stafi”, shtohet fjala “profesional”

Amendamenti 9

Neni 11, paragrafi 3 riformulohet me tekstin si në vijim:

“3. Drejtori i NjIF-K emërohet nga Bordi, i cili duhet të plotësojë kushtet si në vijim:”

Amendamenti 10

Neni 11, paragrafi 3, nënparagrafi 3.4., riformulohet me tekstin si në vijim:

“3.4. të ketë diplomë universitare në fushën e ekonomisë, financave dhe drejtësisë.”

Amendamenti 11

Neni 11, paragrafi 3, nënparagrafi 3.5., riformulohet me tekstin si në vijim:

“3.5. të ketë të paktën 7 (shtatë) vjet përvojë në fushën menaxheriale.”

Amendamenti 12

Neni 11, paragrafi 3, në nënparagrafin 3.6, teksti “Qeverinë e Republikës së Kuvendit të Kosovës:” zëvendësohet me tekstin “Qeverinë e Kosovës, Kuvendin e Kosovës”

Amendamenti 13

Neni 12, paragrafi 1, në rreshtin e katërt, hiqen fjalët “më së miri”

Amendamenti 14

Neni 17, paragrafi 2, në nënparagrafin 2.7., fjala “me indikatorës”, të zëvendësohet me fjalën “me indikatorë”

Amendamenti 15

Neni 19, paragrafi 1, në nënparagrafin 1.2., teksti “duke marrë masa bazuar në rrezik dhe adekuate”, riformulohet me tekstin, “duke marrë masa adekuate bazuar në rrezik dhe”

Amendamenti 16

Neni 19, paragrafi 3, në nënparagrafin 3.2.3., teksti “Ligjit për Subjektet Politike në Kosovë.”, zëvendësohet me tekstin “legjislacionin në fuqi.”

Amendamenti 17

Neni 20, paragrafi 3, në rreshtin e tretë, pas fjalës “periudhën”, shtohet fjala “pesë”

Amendamenti 18

Neni 24, paragrafi 2, teksti “të nenin 19”, zëvendësohet me tekstin “të parapara në nenin 19 të këtij ligji”

Amendamenti 19

Titulli i nenit 27, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 27 Ngrirja e përkohshme e transaksioneve

Amendamenti 20

Neni 28, paragrafi 3, teksti “nëse konsideron se kërkesa a tillë rrezikohen”, zëvendësohen me tekstin “nëse vlerëson se kërkesa e tillë rrezikon”

Amendamenti 21

Neni 31, paragrafi 8, fshihet teksti “Sa të jetë e mundur,”

Neni 31, paragrafi 9, fjala “Shoqata”, zëvendësohet me fjalën “Oda”

Amendamenti 22

Titulli i nenit 33, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 33 Deklarimi i detyruar i qarkullimit të instrumenteve monetare brenda dhe jashtë Kosovës

Neni 33, në paragrafin 3 dhe 12, fjalët “të këtij nenin”, ndryshohen me fjalët “të këtij neni”

Neni 33, paragrafi 13, në rreshtin e parë, fjala “marrin”, zëvendësohet me fjalën “merr”. Si dhe në rreshtin e shtatë fjala “mbajnë”, zëvendësohet me fjalën “mban”

Amendamenti 23

Neni 33, paragrafi 19, në nëpargarafin 19.3, referenca “paragrafi 19”, ndryshohet me referencën “paragrafi 20”

Amendamenti 24

Neni 33, paragrafi 23, hiqet teksti “dhe gjatë ndalimit dhe arrestimit të personit ata do të njihen si zyrtarë të policisë për qëllime të Kodit të Procedurës Penale.”

Amendamenti 25

Neni 34, paragrafi 2.1., fjalët “në vend (terren) i subjektit”, zëvendësohet me fjalët “në vendin e subjektit”

Amendamenti 26

Neni 35, paragrafi 1, në rreshtin e pesëmbëdhjetë, fjala “dispozitat”, ndryshohet me fjalën “dispozitave”

Neni 35, paragrafi 5, në nënparagrafin 5.1, në rreshtin e gjashtë, hiqet fjala e dytë “të këtij ligji”

Amendamenti 27

Neni 39, paragrafi 5, fjala “terrorizmit financimi”, zëvendësohet me fjalën “financim të terrorizmit”

Amendamenti 28

Neni 42, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2.4, riformulohet me tekstin si në vijim:

1.2.4 deri në treqind e pesëdhjetëmijë (350.000) euro apo

Amendamenti 29

Neni 42, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2.5, riformulohet me tekstin si në vijim:

1.2.5. deri në shtatëqindmijë (700.000) euro, për bankat dhe institucionet financiare.

Amendamenti 30

Neni 42, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1. riformulohet me tekstin si në vijim:

2.1. gjobë për secilin prej tyre prej dhjetëmijë (10.000) euro deri në njëqindmijë (100.000) euro;

Amendamenti 31

Neni 43, paragrafi 1.8., teksti “Mos përmbushja e detyrimit të monitorimit”, ndryshohet me tekstin “Mospërmbushja e detyrimit të monitorimit”

Amendamenti 32

Neni 44, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2.4., riformulohet me tekstin si në vijim:

“ 1.2.4. tridhjetëmijë (30.000) euro.

Amendamenti 33

Neni 44, teksti ” Ndëshkimi i parashikuar në këtë nën paragraf, i cili do të jetë i detyrueshëm në të gjitha rastet, mund të vendoset në të njëjtën kohë me atë të listuar në paragrafin 1.1.”, bëhet nënparagrafi 1.3., dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

“1.3. Ndëshkimi i parashikuar në nënparagrafin 1.2., 1.2.1., 1.2.2, 1.2.3. dhe 1.2.4, i cili është i detyrueshëm në të gjitha rastet, mund të vendoset në të njëjtën kohë me ndëshkimin e paraparë në nënparagrafin 1.1.”

Amendamenti 34

Neni 46, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2., riformulohet me tekstin si në vijim:

“ 1.2. gjobë deri në pesëmbëdhjetëmijë (15.000) euro.”

Amendamenti 35

Neni 56, në titull, emri “Veprat penale të”, zëvendësohet me emrin “Vepra penale e”

Amendamenti 36

Neni 59, paragrafi 9, pas references “nenit 33” shtohet fjala “të këtij ligji.

Amendamenti 37

Neni 67, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 67 Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji Nr.03/L-196 për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit dhe Ligji nr.04/L-178 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit.

Mbledhja përfundoi në ora 13:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani